

Bojana Dujković – Bllagojević
Samojko Cvijanović

Të shkolluar apo të dëgjueshëm

Arsimi në Mbretërinë e Jugosllavisë





Pyetja kyçe

“Qëllimi final i arsimit në Jugosllavi 1918-1941 ishte të krijojë qytetar të dëgjueshëm të kombit”. Deri në cilën masë është kjo e saktë kur është në pyetje:

- a) Politika
- b) Praktika
- c) Mësimdhënia



Tema

Ky modul është për arsimin në Mbretërinë Jugosllave në periudhën nga viti 1918 deri në vitin 1941. Kjo temë është zgjedhur sepse nëpërmjet politikës arsimore është e lehtë të shihet si kanë qenë dallimet mes zonave të ndryshme të shtetit dhe si autoritetet përpiqeshin t'i tejkalojnë ato dallime. Tema është relevante për tërë regjionin sepse tregon si janë përshtatur politikat në pjesë të ndryshme të vendit. Edhe pse ligjet vlenin për tërë vendin, kishte shmangie në zbatimin e tyre. Dallimet ishin posaçërisht të mëdha mes veriut dhe jugut, por edhe për shkak të pamundësisë që të arsimohen pakicat.



Rezultatet e mësimit

Kuptimi i bazës së sistemit arsimor në Mbretërinë Jugosllave:

- Nxënësit do t'i vlerësojnë burimet historike në kuptim të vërtetësisë së tyre (dokumentet zyrtare përballë burimeve gojore etj)
- Do ta vlerësojnë qëllimin e shtetit në fushën e arsimit dhe masat e zbatimit.
- Nëpërmjet analizës së burimeve, nxënësit ballafaqohen dhe i kuptojnë kufizimet dhe pengesat me të cilat ballafaqohej shtetit në zbatimin e politikës arsimore.



Qëllimet

Njohja me sistemin arsimor të Mbretërisë Jugosllave. Si dhe në cilën mënyrë shtetit, duke e shfrytëzuar sistemin arsimor, përpiqej të formojë qytetarë të dëgjueshëm të përkushtuar ndaj dinastisë në vend me dallimet e mëdha ekonomike, kulturore dhe në përgjithësi shoqërore. Çka dëshironte të arrijë shtetit nëpërmjet sistemit arsimor, dhe çka arriti të realizojë në praktikë, do të përpiqemi të përgjigjemi në këtë punëtori.



45
minuta

Udhëzime për mësimdhënësi

Mësimdhënësi ua lexon hyrjen nxënësve dhe klasës do t'ia prezantojë temën. Nxënësit duhet të ndahen në tre grupe:

Grupi 1 i analizon qëndrimet dhe synimet e shtetit në kuptim të arsimit të qytetarëve të saj.

Grupi 2 i analizon mënyrat e zbatimi të politikave të proklamuar arsimore

Grupi 3 i parashtron pyetjet për gjendjen e mësimdhënësve, si kryerës të politikës shtetërore:

HAPI 1: Hyrje (konteksti) – mësimdhënësi i ndan nxënësit në 3 grupe dhe ua lexon hyrjen.

HAPI 2: Punë në grupe – secili grup duhet t'i lexojë dhe analizojë burimet, pastaj ta përgatisë prezantimin në tabelë, duke iu përgjigjur pyetjes kyçe të grupit të vet dhe duke e plotësuar tabelën vijuese:

Dëgjueshmëria dhe përkushtimi ndaj kombit

Zhvillimi personal

Nxënësit duhet të gjejnë burime që janë në favor të këtyre pohimeve.

HAPI 3: Diskutim – secili grup do t'i prezantojë rezultatet e tyre.

HAPI 4: Përfundim – në dërrasën e zezë mësimdhënësi duhet t'i shkruajë pyetjet kyçe dhe nëpërmjet diskutimit t'i motivojë nxënësit t'i përgjigjen pyetjes kyçe duke e vlerësuar çdo pohim (5 më i miri, 1 më i dobëti).

Aktivitetet

Grupi 1:

Politika shtetërore në fushën e arsimit.

Detyra e grupit të parë është t'i analizojë burimet të cilat flasin për aktivitetet të cilat i ndërmori shteti në fushën e arsimit (politikat shtetërore të arsimit ose çka premtoi shteti se do të bëhet me arsimin).

Pyetja kyçe:


-Çfarë masash ndërmerre shteti për arsimin? Cilat ishin detyrat e sistemit arsimor të Mbretërisë Jugosllave?

Hyrje

Në vitin 1918 u bashkuan vendet me shkallë të ndryshme arsimore dhe zhvillimore, por edhe me tradita të ndryshme arsimore. Përderisa disa ishin mjaft të zhvilluar, me rrjet të gjerë të shkollave, të tjerët mezi kishin dëgjuar se ekziston shkolla. Sistemi edukativ – arsimor mbështetej në ideologjinë unitare të popullit dhe gjuhës së vetme, por me “emër të trefishtë serbo-kroate-sloven”, dhe idesë të monarkisë centraliste, që shprehej edhe në programet mësimore për punën edukative. Sipas ligjit të shkollave popullore në tërë vendin ekzistonin shkolla fillore katërvjeçare dhe shkolla të larta popullore 3 (nga klasa V deri në klasën VIII) të cilat futen në përdorim gradualisht. Edhe pse sipas ligjit shkollimi tetëvjeçar ishte i detyrueshëm, nxënës të regjistruar kishte dukshëm më pakë sesa numri i nxënësve që u takonte të shkojnë në shkollë. Shkolla fillore kishte shumë pakë, posaçërisht në zonat e pazhvilluara (Maqedoni, Kosovë, Sanxhak, Bosnje dhe Hercegovinë, Likë), prandaj një numër i konsiderueshëm i banorëve mbeti analfabet. Në tërë vendin, mesatarisht një e treta e fëmijëve nuk shkonin në shkollë, ndërsa në vitet 1939/40, në shkollë fillore u regjistruan 50,1% e fëmijëve që ishin në moshë shkollore.

Burimi 1

Përqindja e analfabetëve në Mbretërinë Jugosllave mbi 12 vjet në vitin 1921.



D. Batakovic, Nova istorija srpskog naroda, Beograd 2000, 293

Burimi 2

Kushtetuta e Shën Vidit (“Vidovdanit”) e vitit 1921

Neni 16

Procesi arsimor është shtetëror. Në tërë vendin qëndron në një bazë zë vetme, duke u përshtatur me mjedisin në të cilin zbatohet. Arsimi fillor është shtetëror, i përgjithshëm dhe i obligueshëm. Shkollat profesionale hapen sipas nevojave të profesioneve. Të gjitha institucionet arsimore janë nën mbikëqyrje shtetërore. Shteti do ta ndihmojë punën në arsimimin popullor. Pakicave të racave dhe gjuhëve të tjera u jepet mësim themelor në gjuhën e tyre amtare, me kushte të parapara me ligj.

<http://www.arhivju.gov.rs/active/s>
(Downloaded October 26, 2010)

Burimi 3

Kushtetuta e vitit 1931

Neni 16

“Të gjitha shkollat duhet të ofrojnë edukim moral dhe të zhvillojnë vetëdije shpirtërore në frymën e bashkimit kombëtar dhe tolerancës fetare”.

Digitalna narodna biblioteka Srbije
<http://scc.digital.nb.rs/document/RA-ustav-1931> (downloaded October 26, 2012)

Burimi 4

Himni i Mbretërisë Jugosllave

“Zot, shpëto, Zot ushqe,
mbretin tonë dhe popujt tanë,
mbretin Petar, Zot ushqeje,
Të lutet ty i tërë kombi”.

Burimi 5

Emrat e shkollave

“Nga viti shkollor 1929/30, numri më i madh i shkollave fillore fituan emra të posaçëm. Numri më i madh i emrave është i lidhur me dinastinë. Dhjetëra shkolla mbajnë emrin “Mbreti bashkues”, pastaj “Trashëgimtari i fronit Petar” ose më vonë “Mbreti Petar” dhe emrat e vëllezërve të mbretit dhe princit Pavle”.

Burimi 6

Detyrat e shkollës

Pas vendosjes së diktaturës në vitin 1929 ndryshon edhe politika arsimore. Programi kulturor dhe arsimor i regjimit, të cilin e miratoi paraprakisht mbreti, iu prezantua Këshillit Ministror më 12 mars 1929. Krijuesi i programit, ministri i arsimit Bozhidar Maksimović e theksonte se gjatë tërë periudhës – nga bashkimi deri te vendosja e pushtetit personal, por edhe menjëherë pas kësaj – ekzistonte “tendencë e përhershme, e padukshme, por edhe e pavetëdijshme, për krijimin e qendrave fisnore intelektuale, të cilat në vijë të fundit ngadalë dhe gradualisht çojnë drejt realizmit politik, në vend që veprimi i aktivitetit arsimor të jetë e kundërta”.

Në disa aksione dhe masa të cilat kishin karakter të shprehur ideologjik vend të posaçëm kishte puna në krijimin e programit të vetëm arsimor, barazimin e drejtshkrimit dhe terminologjisë, unifikimin e legjislacionit arsimor, përpilimin e teksteve të njëjta mësimore për shkollat e njëjta, arsimimin popullor... Në programin arsimor detyra e shkollës fillore nuk ishte vetëm ta përhapë shkrimin e leximin, “por, edhe më tepër, të arsimojë në frymën kombëtare”.

Ljubodrag Dimid, *Integralno jugoslovenstvo i kultura 1929-1931. godine*, str. 334-340
<http://www.cpi.hr/download/links/hr/6978.pd> (downloaded October 26, 2012)

Burimi 7

Shkolla fillore Mbreti Petar I, Beograd, Serbi.



Privatna fotografija, porodica Lazarević

Burimi 8

Shtëpia e Sokolave Mbreti Aleksandri I, Rruga Mbreti Aleksandër, Doboj, B. dhe H.



Privatna fotografija, obitelj Dujković

Burimi 9

Emrat zyrtarë të gjuhës amtare në Mbretërinë Jugosllave

- 1918. Gjuha serbe ose kroate
- 1926. Gjuha serbe-kroate-slllovene
- 1934. Gjuha popullore (gjuha serbokroatoslllovene)

M. Papić, *Skolstvo u BiH 1918 - 1941, Sarajevo 1984*, 23-25

Pyetje për grupin 1:

1. Cilat janë dallimet kryesore mes normave të Kushtetutës së vitit 1921 dhe 1931?
2. Cili ishte qëllimi i arsimit pas vendosjes së diktaturës të vitit 1929?
3. Cila ishte figura qendrore në sistemin arsimor të Mbretërisë Jugosllave?
4. Cili ishte qëllimi kryesor arsimor në Mbretërinë Jugosllave?
5. Në cilën mënyrë shteti përpqej që të gjithë qytetarëve të vetë t'u sigurojë të drejta të barabarta arsimore?
6. Çka dëshirohej të arrihet me ndryshimet e emërimit të gjuhës amtare në Mbretërinë Jugosllave?
7. Në cilën masë kjo ishte çështje politike?

Aktivitete

Grupi 2:

Si realizohej politika shtetërore arsimore?

Detyra e grupit 2 është të analizojnë burimet që flasin për mënyrën se si politikatat shtetërore realizoheshin në praktikë.

Pyetja kyçe:

Deri në çfarë mase ishin në dispozicion të drejtat e garantuara kushtetuese për qytetarët e pjesëve të ndryshme të vendit?


Hyrje

Në vitin 1918 u bashkuan vendet me shkallë të ndryshme arsimore dhe zhvillimore, por edhe me tradita të ndryshme arsimore. Përderisa disa ishin mjaft të zhvilluar, me rrjet të gjerë të shkollave, të tjerët mezi kishin dëgjuar se ekziston shkolla. Sistemi edukativ – arsimor mbështetej në ideologjinë unitare të popullit dhe gjuhës së vetme, por me “emër të trefishtë serbo-kroate-sloven”, dhe idesë të monarkisë centraliste, që shprehej edhe në programet mësimore për punën edukative.

Sipas ligjit të shkollave popullore në tërë vendin ekzistonin shkolla fillore katërvjeçare dhe shkolla të larta popullore 3 (nga klasa V deri në klasën VIII) të cilat futen në përdorim gradualisht. Edhe pse sipas ligjit shkollimi tetëvjeçar ishte i detyrueshëm, nxënës të regjistruar kishte dukshëm më pakë sesa numri i nxënësve që u takonte të shkojnë në shkollë. Shkolla fillore kishte shumë pakë, posaçërisht në zonat e pazhvilluara (Maqedoni, Kosovë, Sanxhak, Bosnjë dhe Hercegovinë, Likë), prandaj një numër i konsiderueshëm i banorëve mbeti analfabet. Në tërë vendin, mesatarisht një e treta e fëmijëve nuk shkonin në shkollë, ndërsa në vitet 1939/40, në shkollë fillore u regjistruan 50,1% e fëmijëve që ishin në moshë shkollore.

Burimi 1

Harta me përqindjen e të aftëve për shkrim e lexim sipas provincave në vitin 1931



Lj. Dimic, *Kulturna politika Kraljevine Jugoslavije 1918 - 1941, II, 192*

Burimi 3

Dallimet mes provincave

Vlerësohet se Bosnja dhe Hercegovina në vitin 1937 kishte 2.323.000 banorë. Të dhënat për atë vit shkollor tregojnë se rrjeti shkollor përfshinte rreth 40% të fëmijëve të rritur për shkollë. 60% e fëmijëve mbetën të paregjistruar. Në të njëjtën kohë në provincën e Dravës të gjithë fëmijët u përfshinë në shkollë, ndërsa në provincën e Dunavës gjithsejtë 15% e fëmijëve mbetën jashtë sistemit shkollor.

Mitar Papić, *Školstvo u BiH 1918 – 1941, Sarajevo 1984, str. 23-25*

Burimi 5

Në vitin 1938/39 në shkollë fillore shkante gjithsejtë 9% e popullsisë, ndërsa në shkollë të mesme 1,6% e banorëve të Mbretërisë.

Dušan Bataković, *Nova istorija srpskog naroda, Beograd 2000, str. 293.*

Burimi 2

Ndryshimet në planet dhe programet mësimore

“Shkollat e mësuesve në Bosnje dhe Hercegovinë pas luftës funksiononin sipas ligjeve dhe rregullave të deriatëhershme të periudhës së Austro-Hungarisë. Në planet dhe programet mësimore, si edhe në format e tjera të punës, u hoqën vetëm ata elemente të cilat drejtpërdrejtë mbanin tendenca edukative dhe dëshira të tjera të regjimeve të mëhershme okupuese. Në planet dhe programet mësimore menjëherë u bënë korrigjime të grupeve të lëndëve nacionale (historia, gjeografia dhe gjuha popullore). Edhe në shkollat e mësuesisë, si edhe në programet e shkollave të tjera, theksi i arsimit ishte në historinë e serbëve, kroatëve dhe slovenëve. Si lektyra shkollore jepeshin veprat e njohura të letërsisë serbe, kroate dhe slovene. Çdo gjë që bënte pjesë në apoteozën e dinastisë habzburge u zëvendësua me madhështitë dhe përkushtimet e dinastisë Karagjorgjeviq”.

Mitar Papić, *Školstvo u BiH 1918 – 1941, Sarajevo 1984, str. 82.*

Burimi 4

Arsimi për pakicat

Shkollat e hapura për nxënësit myslimanë kishin mësues serbë, ndërsa mësuesi i lëndëve fetare ishte shqiptar ose turk. Këto të ashtuquajtura orë myslimane i ndiqnin dhe fëmijët shqiptarë të fesë katolike. Mësimin fetar për këto nxënës e mbanin priftërinjtë. Në Mbretërinë Jugosllave, problemet me kroatët katolikë kishin karakter politik, nacional dhe fetar. Në këtë rast, edhe nëse këto orë organizoheshin për pakicën myslimane, fëmijët shqiptarë katolikë ishin të obliguar t'i ndiqnin.

(Z. Volkan i lindur në Prizren në vitin 1928, mësues i pensionuar. Ai i ka ndjekur mësimin në klasat myslimane-serbe në vitet 1935-1936. Kjo intervistë është bërë në shtëpinë e tij më 30 janar 2012.)

Burimi 6

Gjuha zyrtare dhe arsimit

Mendimi i mbikëqyrësit shkollor për qytetin e Manastirit, z. G. Tasiq, për deklaratën e mësueses J. Markoviq, e dorëzuar pranë Sektorit të Arsimit në Manastir, më 30 qershor 1927. "Gjatë këtij viti shkollor nga viset veriore të Manastirit është zhvendosur z-nja Jerina Markoviq së cilës i kisha besuar një klasë të tretë dhe e cila në shikim të parë duket se e zotën mirë gjuhën letrare. Megjithatë, gjatë kontrollimit të punës në klasën e saj, konstatova edhe një gjë që e pranoi edhe ajo gjatë bisedës. Fëmijët përgjigjeshin në gjuhën maqedonase dhe e flisnin gjuhën maqedonase. Kjo më befasoi, sepse kam konstatuar se mësuesja nuk kishte mundësi ose nuk mundej që fëmijëve t'ua sqarojnë nocionin e emrit serb. Nuk është e mundur që fëmijët të kenë kërkuar që ajo të flasë në dialekt në të cilin nuk guxon të realizohet procesi arsimor... Mendimi im parimor dhe modest është që të pastrohet çështja me punëtorët e arsimit që nuk përgjigjen për këto anë".

Д

II, С 1981, 136.

Burimi 8

Beteja e alfabetit cirilik dhe latin



— ГДЕ ОНИХ БУДАЛА ТАМО, ГДЕ СЕ БИЈУ ЗБОГ ЂИРИЛИЦЕ И ЛАТИНИЦЕ, А МИ НЕ ЗНАМО НИ ЈЕДНУ НИ ДРУГУ.

-Shihi ata budallenjtë atje, që zihen për shkak të alfabetit cirilik dhe latin, ndërsa ne nuk e dimë as njërin as tjetrin.

<http://www.udi.rs/gallery.asp?gal=2&sl=10> (26.10.2012)

Pyetje për grupin 2:

1. Cilat dhe sa ishin dallimet në përqindjen e njohjes së shkrimit e leximit mes pjesëve të ndryshme të Mbretërisë?
2. Si mund të sqarohen dallimet e tilla?
3. Cilat ishin pengesat kryesore për zbatimin e Ligjit të Arsimit të cilin e solli shteti?
4. Sa ishin të vetëdijshëm ligdhënësit për problemet reale në teren (analizoje karikaturën)?
5. Në cilën masë analfabetizmi i popullsisë dëshmon për shkallën e zhvillimit të shoqërisë?

Burimi 7

Arsyet për mosndjekjen e shkollës

Kuvendi i Mësuesve të provincës së Drinës mes tjerash u mor edhe me hetimin e arsyeve për vijimin e parregullt të shkollës, dhe vërtetoi se arsyet janë:

- 1) Moszhvillimi i mjaftueshëm i vetëdijes për nevojën dhe dobinë e fëmijëve të shkolluar;
- 2) Varfëria;
- 3) Kushtet e këqija të terrenit dhe rrethanat e komunikacionit;
- 4) Zbatimi i pamundur në praktikë i rregullave ligjore në fuqi për dënimin e atyre që tregojnë neglizhencë.

Izveštaj o situaciji u Drinskoj banovini, knjiga 3 (1936-1939), ur. Andrej Rodinis, 646, Sarajevo 2011.

Burimi 9

Pozita e mësimdhënësve për planin dhe programin

Kuvendi i Mësuesve të provincës së Drinës në mbledhjen e tij III gjatë ditëve 11, 12, 13 mars 1939 u mor gjerësisht me çështjen e planit dhe programit të sotëm mësimor për shkollat fillore popullore, dhe konstatoi që plani dhe programi i tanishëm mësimor nuk i përgjigjet numrit të orëve, as përzgjedhjes së lëndëve mësimore të vendosura me normat e nenit 1 të Ligjit të Shkollave Popullore, i cili flet për detyrat e shkollave popullore; që plani dhe programi i sotëm mësimor sipas përbërjes së tij të brendshme nuk i përgjigjet parimeve të vendosura në nenin 44 të Ligjit të Shkollave Popullore; që shkollat tona popullore punojnë sipas kushteve të ndryshme dhe që ka lloje të ndryshme të shkollave (të ndara, të pandara, të fshatit, të qytetit, të pakicave) dhe është e pamundur që plani dhe programi i sotëm i vetëm të mund të zbatohet në të gjitha llojet e ndryshme të shkollave.

Izveštaj o situaciji u Drinskoj banovini, knjiga 3 (1936-1939),

Burimi 10

Dallimet mes fëmijëve

"Dy orë mbaheshin në kuadër të kishës katolike. Mësuesja jonë ishte murgeshë. Gjysma e nxënësve ishin myslimanë, ndërsa gjysma tjetër ishin katolikë, veçanërisht në Prizren, edhe pse kishte dallime nacionale mes fëmijëve myslimanë. Dy herë në javë, të martën dhe të premten, kishim orë për mësim fetar".

(Z. Volkan i lindur në Prizren në vitin 1928, mësues i pensionuar. Ai i ka ndjekur mësimin në klasat myslimane-serbe në vitet 1935-1936. Kjo intervistë është bërë në shtëpinë e tij më 30 janar 2012.)

Aktivitetet

Grupi 3:

Zbatuesi i politikave arsimore – mësues, zotëri apo shërbëtor i shtetit?!

Grupi i tretë i analizon burimet që flasin për pozitën e mësuesve, d.m.th. atyre që janë zbatuesit kryesorë të politikave të proklamuar arsimore.

Pyetja kyçe:

A ndikonte shteti te mësimdhënësit dhe si, që të bëhen propagandues të politikës shtetërore?

Mësimdhënësit ishin zyrtarë shtetërorë që detyrën e fitonin me dekret të ministrit të arsimit. Meqë arsimit dhe aftësimi për shkrim e lexim i popullsisë proklamohet si njëri nga prioritetet e politikës shtetërore, arsimimit të mësuesve të ardhshëm u kushtohet vëmendje e madhe. Meqë nevoja për mësues kishte shumë, ndërsa mësues pak, ishin të detyruar që shpesh të shpërngulen dhe t'i ndryshojnë vendet e punës.

Burimi 1

Ligji i Shkollave të Mësuesisë

Neni 1. Shkollat e Mësuesisë shërbejnë për arsimimi profesional të mësuesve të shkollave popullore. Detyrën e tyre e realizojnë si vijon:

Duke u dhënë praktikantëve përgatitje themelore të përgjithshme dhe profesionale (përgatitje pedagogjike);

Duke i edukuar në frymën e bashkimit shtetëror dhe popullor dhe tolerancës fetare;

Duke i trajnuar dhe mësuar që në shkollë për misionin nacional, arsimor dhe kulturor në popull, veçanërisht në fshat.

Zakon o u iteljskim kolama iz septembra 1929. Preuzeto iz: M. Papi, *Školstvo u BiH 1918-1941*, Sarajevo, 1984, str. 177.

Burimi 3

Liria e mësuesve

“Në vitin 1926 Ministria e Arsimit e sjell vendimin që mësueset nuk mund të martohen pa pëlqimin e Ministrisë së Arsimit. Ministri Dobrivoje Stoshoviq shkoi një hap më tej duke sjellë vendim që mësueset mund të martohen vetëm me mësues, nëse dëshirojnë të mbeten në detyrë”.

M. Papić, *Školstvo u BiH 1918-1941*, Sarajevo, 1984, str. 177

Burimi 5

Shpërnguljet e shpeshta të mësimdhënësve

Rasti i mësueses Evica Batistiq nga Vrpolja. Ka mbaruar shkollën e mësuesisë në Osijek në vitin 1926.

Ka punuar si mësuese gati 19 vjet. Gjatë kësaj periudhe disa herë ka qenë e obliguar ta ndryshojë vendin e punës së saj. Filloi në vitin 1928 në vendin Hrani (Kroaci), në vitin 1934 kaloi në Paleshnik (Kroaci), në vitin 1940 kalon në Blato në Korçullë (Kroaci), që në vitin 1941 të vendoset në vendin Odzhaci (Vojvodinë). Një kohë të shkurtër punoi në Maqedoni. Lufta e gjeti në Vojvodinë.

Të dhënat janë marrë nga Muzeu i Osijekut

Burimi 2

Mësimdhënësit – bartës të idesë shtetërore

Në programin arsimor detyra e shkollës fillore nuk ishte vetëm të përhapë shkrim e lexim “por, edhe më tepër, të edukojë në frymën nacionale”. Shkollës ia zihet për të madhe që, në dekadën e parë të ekzistimit të shtetit jugosllav, nuk iu përgjigj kësaj detyre. Autoritetet arsimore i gjykonin se nuk kishin “as kuptim, as fuqi” t’i detyrojnë mësimdhënësit të jenë “në nivelin e detyrës së tyre”. Nga mësimdhënësi kërkohet të jenë “bartës të idesë shtetërore”. Shkollat e mësuesisë ishin të obliguara të japin “kuadër mësimor i cili në punën e tij të mësuesit nuk do të vijë në kolizion me idetë e rëndësishme të rregullimit të shtetit, në formë të sundimit, për rendin shoqëror, si edhe për bashkimin shtetëror dhe popullor”.

Ljubodrag Dimić, *Integralno jugoslovenstvo i kultura 1929-1931. godine*, str. 334-340

[http://www.cpi.hr/download/links/hr/697/downloaded October 26, 2012](http://www.cpi.hr/download/links/hr/697/downloaded%20October%2026,%202012)

Burimi 4

Kodi i veshjes së rregullt për mësueset

Më 28 qershor 1925 Ministri i Arsimit e jep këtë urdhëresë interesante: “Ministria e Arsimit shpesh pranon ankesa nga inspektorët e arsimit, mbikëqyrësit shkollorë, kryesuesve të qarqeve dhe të tjerëve të cilët e kthejnë vëmendjen e Ministrisë për veshje të pahijshme të mësuesve, duke cituar që shpesh në mesin e popullit shiheshin vajza të reja me fustan deri në gjunjë dhe mëngët deri në bërryl, me dekolte të hapur së tepërmi që i fyejnë edhe nocionet më primitive të bukurisë, fisnikërisë dhe mirësjelljes duke e marrë parasysh mjedisin në të cilin lëvizin. Që t’u dilet përpara dukurive të këtilla, urdhëroj që mësueset, nga viti i ardhshëm shkollor, në rrugë, e veçanërisht në shkollë, në detyrë, të mbajnë veshje modeste që do t’i përgjigjen seriozitetit të pozitës dhe ndikimit edukativ, të cilin duhet ta kryejnë ata në mjedisin e tyre...”

100 godina osnovne škole u Boljaniću, Doboj 1996, str. 101

Burimi 6

Zhvendosja e mësuesve

“Nuk sqarohet lehtë dukuria e zhvendosjes së mësimdhënësve në mes të vitit shkollor për dëshirën e dikujt. Cili pushtet e merr për sipër kompetencën dhe moskompetencën për raportet ndaj mësuesve që kanë gabuar, të manifestuar ndaj të gjitha erërave politike... Kjo bëhet për shkak të vullnetit politik të dikujt, mësuesi ndahet nga familja, ose gjatë dimrit të madh lufton për vend të ri. Por, ky nuk është problemi i vetëm. Pamjen e errët e jep edhe rroga e dobët e mësuesit. Punëtorët ndihmës të shkollës nuk pranajnë rrogë gjatë tërë vitit, nxënësit janë pa libra dhe mjete themelore etj. Edhe mësuesit kanë rroga mizore (fillestarët kanë 900 dinarë rrogë) të cilin nuk e marrin rregullisht...”

”

“, . 485, 13.03.1937,

Burimi 7 Profesorët dhe rreshterët



Rreshteri: Të gjithë ne e dinim që ti si nxënës më i mirë do të bëhesh profesor, ndërsa mua si nxënës i dobët më larguan nga shkolla dhe tani jam rreshter i thjeshtë.

Profesori: Eh sikur të isha edhe unë nxënës i keq.

<http://www.udi.rs/gallery.asp?gal=2&sl=12> (downloaded October 26, 2012)
Karikatura Profesor i narednici

Pyetje për grupin 3:

1. Renditi burimet sipas rëndësisë! Gjeje burimin më të rëndësishëm, nga të ofruarit, nga këndvështrimi i lirisë personale të mësuesit!
2. Përveç arsimit të nxënësve, cilat ishin detyrat më të rëndësime të mësuesve?
3. Çka prisnin autoritetet shtetërore nga mësuesit e tyre?
4. Cili ishte raporti i shoqërisë ndaj mësuesve?
5. Deri në cilën masë nxënësit kishin liri personale?
6. A ishim mësuesit të manifestuar ndaj shtypjeve politike?